

KLAUZOLAT E NDËRMJETËSIMIT TË ICC-SË

Palët që dëshirojnë të ndjekin procedurat sipas Rregullave të Ndërmjetësimit të ICC-së, duhet të zgjedhin një nga klauzolat e mëposhtme, që mbulojnë rrethana dhe nevoja të ndryshme. Palët janë të lira ta përshtatin klauzolën në bazë të rrethanave, sipas rastit përkatës. Për shembull, ato mund të duan të përcaktojnë përdorimin e një procedure tjetër për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në vend të ndërmjetësimit. Krahas kësaj, ato mund të duan gjithashtu të përcaktojnë gjuhën dhe vendin e procedurës së ndërmjetësimit dhe/ose arbitrazhit.

Shënimet në fund të secilës klauzolë kanë për qëllim t'i ndihmojnë palët të zgjedhin klauzolën që përmbush më së miri kërkesat e tyre specifike.

Gjatë hartimit të klauzolës, duhet të tregohet kujdes që të shmangen paqartësitë. Formulimi i paqartë shkakton pasiguri dhe vonesa, si dhe mund të pengojë, madje edhe të kompromentojë procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Nëse palët përfshijnë një nga klauzolat e mëposhtme në kontratat e tyre, ato duhet të kenë parasysh faktorët që mund të ndikojnë në zbatueshmërinë e klauzolës sipas ligjit të zbatueshëm.

Klauzola A: Opsioni për të Zbatuar Rregullat e Ndërmjetësimit të ICC-së

Në çdo kohë dhe pa cenuar procedura të tjera, palët mund të zgjedhin që t'i zgjidhin mosmarrëveshjet që lindin nga apo në lidhje me këtë kontratë në përputhje me Rregullat e Ndërmjetësimit të ICC-së.

Shënime: Me parashikimin e kësaj klauzole, palët pranojnë se janë të vetëdijshme që mund të ndjekin procedurat sipas Rregullave të Ndërmjetësimit të ICC-së. Kjo klauzolë nuk iu ngarkon palëve asnjë përgjegjësi, por parashikimi e saj ka për qëllim t'i rikujtojë palëve mundësinë për të ndjekur procesin e ndërmjetësimit ose procedura të tjera zgjidhjeje në çdo kohë. Krahas kësaj, ajo mund të shërbejë si bazë që palët t'i propozojnë njëra-tjetrës të ndjekin procesin e ndërmjetësimit. Gjithashtu, njëra ose më shumë nga palët, mund të kërkojë asistencë nga Qendra Ndërkombëtare e ICC-së për ADR në këtë proces.

Klauzola B: Detyrimi për të Marrë në Konsideratë Rregullat e Ndërmjetësimit të ICC-së

Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje që lind nga apo në lidhje me këtë kontratë, palët bien dakord që fillimisht të diskutojnë dhe të marrin në konsideratë paraqitjen e mosmarrëveshjes për ndërmjetësim sipas Rregullave të Ndërmjetësimit të ICC-së.

Shënime: Kjo Klausolë shkon një hap më tej se sa Klausola A dhe kërkon nga palët që, në rast të një mosmarrëveshjeje, ta diskutojnë dhe marrin në konsideratë bashkërisht referimin e mosmarrëveshjes për ndërmjetësim sipas Rregullave të Ndërmjetësimit të ICC-së. Njëra palë, ose më shumë, mund të kërkojë ndihmën e Qendrës Ndërkombëtare të ICC-së për ADR në këtë proces.

Kjo klausolë mund të jetë e përshtatshme në rastin kur palët nuk dëshirojnë të angazhohen se do ta paraqesin mosmarrëveshjen për ndërmjetësim sipas Rregullave që në fillim, por parapëlqejnë të kenë mundësinë që të vendosin ose jo nëse do të përdorin ndërmjetësimin për të zgjidhur mosmarrëveshjen.

Klauzola C: Detyrimi për ta Paraqitur Mosmarrëveshjen për Ndërmjetësim sipas Rregullave të Ndërmjetësimit të ICC-së duke Lejuar Njëkohësisht Arbitrazh Paralel nëse Nevojitet

(x) Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje që lind nga apo në lidhje me këtë kontratë, palët e paraqesin fillimisht mosmarrëveshjen për ndërmjetësim duke ndjekur procedurat sipas Rregullave të Ndërmjetësimit të ICC-së. Fillimi i procedurave të Rregullave të Ndërmjetësimit të ICC-së nuk pengon asnjërën nga palët për të filluar procesin e arbitrazhit në përputhje me nënklausolën y më poshtë.

(y) Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin nga apo në lidhje me Kontratën në fjalë, zgjidhen përfundimisht sipas Rregullave të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë me një ose më shumë arbitra të caktuar në përputhje me këto Rregulla.

Shënime: Kjo klausolë i detyron palët që ta paraqesin mosmarrëveshjen për ndërmjetësim sipas Rregullave të Ndërmjetësimit të ICC-së. Ajo është hartuar për të siguruar që, në rastin e një mosmarrëveshjeje, palët do të përpiqen ta zgjidhin mosmarrëveshjen nëpërmjet procedurave të përcaktuara sipas Rregullave.

KLAUZOLAT E NDËRMJETËSIMIT TË ICC-SË

Klauzola gjithashtu sqaron se palët nuk kanë nevojë të presin përfundimin e procedurave sipas Rregullave të Ndërmjetësimit të ICC-së apo të presin për një periudhë kohe të dakordësuar për të filluar procedurat e arbitrazhit. Kjo përcaktohet dhe në Nenin 10(2) të Rregullave.

Kjo klauzolë parashikon arbitrazhin e ICC-së si mekanizmin për zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjes. Nëse palët duan, kjo klauzolë mund të përshtatet për të përcaktuar një formë tjetër arbitrazhi, ose një procedurë gjyqësore ose procedurë tjetër të ngjashme.

Klauzola D: Detyrimi për ta Paraqitur Mosmarrëveshjen për Ndërmjetësim sipas Rregullave të Ndërmjetësimit të ICC-së, e Ndjekur nga Arbitrazhi nëse Nevojitet

Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje që lind nga apo në lidhje me këtë kontratë, palët e paraqesin fillimisht mosmarrëveshjen për ndërmjetësim sipas Rregullave të Ndërmjetësimit të ICC-së. Nëse mosmarrëveshja nuk është zgjidhur në përputhje me Rregullat në fjalë brenda [45] ditëve pas depozitimit të Kërkesës për Ndërmjetësim, apo brenda një periudhë të miratuar me shkrim nga palët, kjo mosmarrëveshje zgjidhet në mënyrë përfundimtare sipas Rregullave të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë nga një ose më shumë arbitra të caktuar në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit.

Shënime: Sikurse Klauzola C, edhe kjo klauzolë i detyron palët që ta referojnë mosmarrëveshjen për ndërmjetësim sipas Rregullave të Ndërmjetësimit të ICC-së.

Megjithatë, ndryshe nga Klauzola C, kjo klauzolë parashikon se procedurat e arbitrazhit nuk mund të fillojnë pa kaluar një periudhë e dakordësuar pas dorëzimit të Kërkesës për Ndërmjetësim. Koha e përcaktuar që propozohet në këtë shembull klauzole është 45 ditë, por palët duhet të zgjedhin periudhën që mendojnë se është më e përshtatshme për kontratën në fjalë.

Klauzola D ndryshon përcaktimin e përgjithshëm sipas Nenit 10(2) të Rregullave të Ndërmjetësimit të ICC-së, ku lejohet fillimi i procedurave gjyqësore, të arbitrazhit, ose të ngjashme, paralelisht me procedurat sipas Rregullave të Ndërmjetësimit të ICC-së.

Sikurse Klauzola C, Klauzola D përcakton arbitrazhin e ICC-së si forumin për zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjes. Nëse palët duan, kjo klauzolë mund të përshtatet për të përcaktuar një formë tjetër arbitrazhi, apo një procedurë gjyqësore ose të ngjashme.

Çështje Specifike Lidhur me Dispozitat për Arbitrin e Emergjencës

Palët duhet të vendosin nëse dëshirojnë që të zbatojnë Dispozitat për Arbitrin e Emergjencës sipas Klauzolës C dhe D.

Klauzola C dhe D

Nëse palët dëshirojnë që Dispozitat për Arbitrin e Emergjencës të mos zbatohen, atëherë në Klauzolën C dhe D duhet të shtohet fjalia si më poshtë:

Dispozitat për Arbitrin e Emergjencës nuk zbatohen.

Klauzola D

1. Nëse palët dëshirojnë që Dispozitat për Arbitrin e Emergjencës të zbatohen, dhe duan që ky opsion të jetë shprehimisht i mundshëm përpara përfundimit të afatit 45-ditor, ose periudhës së përcaktuar, nga dorëzimi i Kërkesës për Ndërmjetësim, atëherë në Klauzolën D duhet të shtohet fjalia si më poshtë:

Kërkesa për të pritur [45] ditë, apo për një periudhë tjetër të dakordësuar, nga dorëzimi i Kërkesës për Ndërmjetësim përpara se një mosmarrëveshje të mund të paraqitet për arbitrazh, nuk i pengon palët që të bëjnë një kërkesë, përpara përfundimit të [45] ditëve ose periudhës së dakordësuar, për Masa Emergjence në Dispozitat për Arbitrin e Emergjencës në Rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.

2. Nëse palët dëshirojnë që Dispozitat për Arbitrin e Emergjencës të zbatohen, por vetëm pas përfundimit të afatit 45-ditor, ose periudhës së përcaktuar, nga dorëzimi i Kërkesës për Ndërmjetësim, atëherë në Klauzolën D duhet të shtohet fjalia si më poshtë:

Palët nuk kanë të drejtë të bëjnë kërkesë për Masa Emergjence sipas Dispozitave për Arbitrin e Emergjencës në Rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë përpara përfundimit të afatit prej [45] ditësh ose periudhës së dakordësuar pas dorëzimit të Kërkesës për Ndërmjetësim.